



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 852/g Prot.

Durrës, më 11.03.2025

VENDIM

Nr. 30, datë 11.03 2025

PËR

"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 50, DATË 26.11.2024 "PËR RIORGANIZIM MBI MASËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË "TEKNOLOGJI INFORMACIONI", PRANË DEPARTAMENTIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e kreut IV/A; në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Vendimin e Senatit Akademik Nr. 50, datë 26.11.2024, si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 849 prot., datë 11.03.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 50, datë 26.11.2024 "Për riorganizimin mbi masën 20% të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Teknologji Informacioni", pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", bëhen cilësimet si më poshtë:

- a) Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën shqipe;
 - b) Kodi i programit të studimit: **S63BA0610**.
2. Ky vendim i përcillet për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

